

## **BASHKIA DROPULL**

### **RAPORT PER PLANIN E MASAVE NE ZBATIM TE REKOMANDIMEVE TE AUDITIT TE KONTROLLIT TE LARTE TE SHETIT.**

Mbeshtetur ne nenin 50 "Auditimi I Jashtem" pika 5 e ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" kryetari I Bashkise raporton ne Keshill per zbatimin e rekomandimeve te lena nga auditimi I jashtem. Ne Bashkine tone u ushtrua kontroll nga KLSH-ja per periudhen Korrik 2019-Dhjetor 2020. Me marjen e Raportit Perfundimtar dhe rekomandimet per auditin e ushtruar ne Bashkine Dropull "Mbi auditimin financiar dhe te perputhshmerise " me Nr.869/7 prot dt.20.12.2021 protokolluar me nr.2346 prot.dt.28.12.2021 prane Bashkise, nga kryetari i Bashkise Z.Dhimitraq TOLI u be njohja me materjalin e te gjitha personave pergjegjes qe perfshihen ne kete raport.

Cdo Drejtori beri nje analize te vecante me punonjesit e saj per problemet e dala ne raport dhe ne dt.07.01.2022 nen drejtimin e Kryetarit te Bashkise Z.Dhimitraq TOLI u zhvillua nje takim me administraten e Bashkise ku u analizuan nje per nje te metat dhe rekomandimet e lena me qellim permiresimin e punes ne institucion dhe marjen e masave per zbatimin e rekomandimeve.

Kryetari me urdherin nr.4 dt. 07.01.2022 dhe nr.11 prot. caktoi dhe grupin e punes per hartimin e plan veprimit ku te percaktohen dhe personat pergjegjes per ndjekjen e ketij plan veprimi dhe afatet konkrete per zbatimin e tij.

#### **A-MASAT ORGANIZATIVE**

Per zbatimin e rekomandimeve deri ne kete periudhe jane mare masat si me poshte:

**1.1 Rekomandim:** Drejtorja e të Ardhurave të ndjekë intensivisht zbatimin e urdhrin që ka nxjerrë për bllokimin e llogarive bankare për subjektet debitore, si dhe të marrë masat e duhura administrative e ligjore me qëllim arrijten e rezultateve reale në uljen e borxhit prej **11,092,920 lekë** nga subjektet dhe familjet debitore si dhe të dokumentojë ndjekjen dhe rezultatet e këtyre masave.

#### **Në vijimësi**

Ky rekomandim do gjeje zbatim ne vijimesi duke filluar menjehere me bllokimin e llogarive ,njoftimin e familjeve dhe ndjekjen hap pas hapi te debitoreve.

**2.1 Rekomandim:** Drejtorja e të Ardhurave të marrë masa që dy subjektet që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, të pajisen menjëherë me autorizimin përkatës duke filluar nga periudha kur ka përfunduar autorizimi paraprak.

#### **Menjëherë**

U njoftuan menjehere subjektet per lidhjen e nje mareveshjeje per kryerjen e pageses me keste per pajisjen me autorizimin perkates.Te dy subjektet filluan pagesen me keste sipas mareveshjes se nenshkruar.